



**Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDARYSHE**

1 shkurt 2014, Prizren

REAGIM

Zvarritja e emërimit të drejtorëve porosi e keqe për qytetarët

EC Ma Ndryshe është duke e përcjellë me shqetësim procesin e zvarritjes së emërimit të drejtorëve të komunës së Prizrenit. Edhe pse kanë kaluar pothuajse dy muaj nga certifikimi i rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve lokale të vitit 2013 nga KQZ-ja për kuvende dhe kryetarë të komunave, ekzekutivi i komunës së Prizrenit nuk është konsoliduar ende. Kryetari i komunës së Prizrenit deri më tani nuk ka ofruar arsye kredibile për këtë vonesë, e cila po ndikon në dinamikën e përgjithshme të qeverisjes lokale dhe realizimit të punëve nga ekzekutivi. Kësaj situatë i ka paraprirë edhe periudha e fushatës zgjedhore dhe dy raundeve të zgjedhjeve për kryetar komune, që është karakterizuar me dinamikë shumë të ulët të ekzekutimit të punëve nga qeveria lokale.

EC Ma Ndryshe konsideron se kjo zvarritje shkon në dëm të interesit të përgjithshëm publik dhe përmban një porosi të keqe për qytetarët. Vakuumi aktual institucional pamundëson ekzekutimin efektiv të punëve të qeverisë lokale, duke iu mohuar qytetarëve të komunës së Prizrenit marrjen e shërbimeve cilësore dhe në kohën e duhur. Qytetarët e Prizrenit me votën e tyre e kanë autorizuar kryetarin e komunës që të qeverisë me punët e komunës dhe të ofrojë shërbime publike. Mbi të gjitha, kryetari i komunës është i obliguar edhe me ligjin e aplikueshëm në vend që këtë autorizim ta përkthejë në qeverisje efektive dhe demokratike në shërbim të qytetarëve të komunës.

Arsyetimi se bëhet fjalë për vazhdimësi në qeverisje nuk është justifikim i qëndrueshëm, pasi që qytetarët i kanë besuar mandat të ri kryetarit të komunës dhe ai duhet të legjitimoj ekzekutivin e mandatit të ri. Vonesat e pakuptimta në këtë drejtim janë dëshmi e papërgjegjësisë institucionale, ligjore dhe politike të kryetarit të komunës. Praktikisht, nga shtatori i vitit të kaluar, qeveria lokale e Prizrenit ka qenë pothuaj tërësisht jofunksionale. Prandaj, ne i bëjmë thirrje kryetarit të komunës së Prizrenit që në pajtim me obligimet ligjore, të mos presë as edhe një sekondë më tepër për emërimin e drejtorëve komunalë, për t'u siguruar që qytetarëve u ofrohen shërbimet dhe qeverisja funksionon në mënyrë të rregullt.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren
Rr. Perandori Dioklician 14 Kati V (te Qafa) - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti "Transparenca online e komunave të Prizrenit dhe Mamushës" prej muajit maj 2013 përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.